

**Numri:** KSC-BC-2020-05  
**Prokurori i Specializuar kundër z. Salih Mustafa**

**Vendos:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatësi Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Pjesëmarrësi parashtrues:** Mbrojtja

**Datë:** 20 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Parashtrim i Mbrojtjes për**

rishikimin e paraburgimit të të akuzuarit

---

**Zyrës së Prokurorit të  
Specializuar**

z. Xhek Smith

**Mbrojtësi i të akuzuarit**

z. Julius von Bone

## I. Ecuria e çështjes dhe urdhri i Gjykatësit të Procedurës Paraprake

1. Mbrojtja ka marrë dijeni mbi përmbajtjen e urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake lidhur me rishikimin e paraburgimit të të akuzuarit. Në këtë çështje, paraburgimi bazohet në përmbajtjen e Aktakuzës së Konfirmuar, të fletarrestimit dhe të urdhrit të transferimit të datës 12 qershor 2020. Arrestimi u krye më datë 24 shtator 2020 dhe i akuzuari u transferua po atë datë në objektin e paraburgimit të DHSK-së, në Hagë.

2. I akuzuari, zoti Salih Mustafa, akuzohet për një sërë veprash penale, që pretendohet se janë kryer në vitin 1999. Konfirmimi i aktakuzës thotë se ekziston dyshim i bazuar mirë se zoti Mustafa ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e veprave penale të pretenduara.

3. Zoti Mustafa ka deklaruar pafajësinë e tij për secilën prej pikave të Aktakuzës.

4. Zakonisht një person i akuzuar prezumohet i pafajshëm gjer në vërtetimin e akuzave përtej dyshimit të arsyeshëm përpara një gjykatësi të pavarur.

5. Mbrojtja parashton se, pas konfirmimit të Aktakuzës, duhet menduar nëse do të ishte e nevojshme të mbahej në paraburgim i akuzuari, i cili më parë ka qenë mbi 20 vjet në liri. Brenda asaj periudhe kohore, gjatë kohës kur ka jetuar në Kosovë, i akuzuari nuk është shpallur i fajshëm për asnjë vepër penale. Dhe ai nuk është larguar thuajse fare nga vendi i tij.

6. Megjithatë, gjatë gjithë këtyre viteve deri tani, asnjë deklaratë e veçantë në lidhje me përfshirjen e tij në ndonjë vepër të caktuar penale, nuk ka dalë në dritë në këtë çështje. Vetëm hetimi i ZPS-së ka nxjerrë në dritë ndonjë provë fajësuese.

Rrjedhimisht, prova të tilla të paraqitura nga ZPS-ja përpara Gjykatësit të Procedurës Paraprake lipsen të merren në shqyrtim të kujdesshëm nga ana e Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Mbrojtja parashtron se standardi i zgjatjes së kohës së paraburgimit kërkon që sa më e gjatë periudha e paraburgimit, aq më të forta duhet të jenë provat. Dhe këto prova duhen paraqitur nga ZPS-ja.

7. Provat e pretenduara, të cilat na janë zbuluar vetëm tani me materialet e çështjes, gjer më sot nuk janë testuar në asnjë mënyrë sa i takon vërtetësisë së pretendimeve të ngritura nëpër deklaratat e zbuluara gjer më tani.

8. As gjykatësit, as Mbrojtja, nuk kanë pasur mundësi të testojnë vërtetësinë e tyre. Gjithashtu, ZPS-ja nuk i ka mbështetur (edhe sot e kësaj dite) pretendimet e ngritura në deklaratat fajësuese. Rrjedhimisht, themeli i provave, në këtë pikë, përbëhet vetëm nga deklaratat, që (në sipërfaqe) janë marrë pa materiale (të tjera) të lidhura të cilat do të mbështetnin pretendimet e ngritura në brendësi të deklaratave.

9. Për këtë qëllim, dyshimi i bazuar mirë, siç është shprehur në Aktakuzë, duhet të merret të shqyrtim. Me fjalë të tjera: sa i bazuar mirë është ky dyshim sot, pas materialeve të vendosura në dispozicion deri tani nga ZPS-ja?

10. Mbrojtja parashtron se pas më shumë se pesë muajsh që nga konfirmimi i Aktakuzës, ZPS-ja nuk ka vendosur në dispozicion asnjë material prej të cilit mund të arrihet në mënyrë objektive në përfundimin se pretendimet e ngritura në deklaratat fajësuese kanë bazë tjetër mbështetëse. ZPS-ja nuk ka vendosur në dispozicion materiale objektive dhe vetëm fillimisht (pra: në momentin kur ZPS-ja bëri kërkesën për konfirmimin e aktakuzës) i paraqiti materiale Gjykatësit të Procedurës Paraprake, që mund të kenë çuar asokohe në nxjerrjen e përfundimit se ekzistonte një dyshim i bazuar mirë.

11. Mbrojtja parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhet ta marrë në shqyrtim masën e mbajtjes së të akuzuarit në paraburgim, në bazë të materialeve të tanishme mbi çështjen, dhe të konstatojë nëse sot e kësaj dite (kur kanë kaluar 5 muaj) janë paraqitur materiale të tilla shtesë të cilat do t'i mbështetnin pretendimet e ngritura në deklaratat fajësuese. Krahas kësaj, materialet do të duhej të dëshmonin të paktën përfshirjen e drejtpërdrejtë të të akuzuarit në *secilën* prej veprave penale të pretenduara.

12. Më tej, Mbrojtja parashtron se thjesht deklaratat nuk mund të përbëjnë bazën e përfundimit se krimet e pretenduara janë urdhëruar nga i akuzuari, e jo më pastaj që i akuzuari vetë t'i ketë kryer apo të ketë marrë pjesë në kryerjen e secilës prej veprave penale.

13. Edhe pse Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka asnjë detyrim për të nxjerrë në këtë moment përfundime lidhur me themelin e deklaratave, Mbrojtja beson dhe parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në konsideratë të çdo zgjatjeje të qëndrimit në paraburgim të të akuzuarit, mund dhe duhet t'i kërkojë ZPS-së të vendosë në dispozicion prova më "të forta" dhe më objektive se sa thjesht deklarata, pavarësisht nga sa fajësuese mund të duken apo të tingëllojnë këto të fundit.

14. Tekefundit, mbajtja e në paraburgim e çdo individ nuk duhet të jetë një vendim i cili të merret lehtë dhe pa mbajtur në konsideratë ndikimin që do të kishte te individ heqja e beftë e lirisë dhe largimi nga jeta familjare dhe nga jeta profesionale (pra, nga puna), thjesht dhe vetëm në bazë të disa deklaratave të cilat e lidhin me një vepër penale.

15. Mbrojtja parashtron se për një dyshim të bazuar, në këtë moment dhe në këtë fazë të procesit dhe sidomos për çështjen nëse duhet zgjatur paraburgimi i të akuzuarit, ZPS-ja nuk mund të mbështetet vetëm në deklarata dëshmitarësh, një apo më shumë

qofshin, për justifikimin e zgjatjes së paraburgimit të të akuzuarit. Për *secilën* prej pikave të Aktakuzës, ZPS-ja ka detyrimin të bazohet në materiale mbështetëse që janë objektive dhe nuk mund të vihen në diskutim. Materiale të tilla do të duhej të mbështetnin *secilin* prej pretendimeve të bëra nga dëshmitarët dhe të mbështetnin në veçanti *secilën* prej akuzave dhe mënyrave të kryerjes së krimit.

## **II. Në mungesë të provave shtesë objektive, është veçse e drejtë që i akuzuari të lihet në gjendje të lirë, me ose pa kushte të vendosura nga paneli.**

16. Në pikat e mësipërme, Mbrojtja argumenton se sa më gjatë t'i hiqet të akuzuarit një prej të drejtave më themelore të njeriut (liria), është e rëndësishme që ZPS-ja të mos mbështetet vetëm në deklaratat në kërkimin e vijimit të qëndrimit të tij në paraburgim dhe të mos kërkojë që zgjatja e paraburgimit të bëhet me nismën e vet dhe pa materiale të tjera shtesë.

17. Në mungesë të tyre, i akuzuari duhet liruar. Përndryshe, në mungesë të materialeve shtesë, zgjatja e paraburgimit duhet ndaluar për ato akuza për të cilat nuk janë paraqitur materiale shtesë. Me fjalë të tjera: mbajtja në paraburgim për një akuzë të caktuar nuk mund të vijojë nëse për atë akuzë nuk janë paraqitur materiale objektive shtesë. Materialet e paraqitura nuk duhet të jenë materiale "të tjera të po atij lloji" (pra, deklaratat të tjera).

18. Duke qenë se në këtë çështje nuk ekzistojnë materiale të tilla, i akuzuari duhet të lirohet.

### III. Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose trupi gjykues mund të vendosë nëse duhet vendosur ndonjë kusht.

19. Mbrojtja është e mendimit se, nëse mendohet lirimi, kushtet e parashikuara në nenin 41 (12) (a)-(d) të Ligjit mund të zbatohen vetëm nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake apo trupi gjykues bën konstatime të veçanta për të akuzuarin, nëse: ky do të jetë ose jo i pranishëm gjatë procesit, nëse ka apo jo ndonjë rrezik të justifikuar se i akuzuari do të rikryente një vepër penale, apo nëse ka apo jo diçka që do ta vinte në rrezik zhvillimin e suksesshëm të procesit penal.

20. Neni 41 (12) përcakton masat që *mund të* vendosen me urdhër, çka nënkupton se ky nen nuk dikton në asnjë mënyrë që masat e parashikuara në këtë nen të jenë të detyrueshme. Gjykatësi i Procedurës Paraprake apo trupi gjykues mund të vendosë gjithashtu edhe moszbatimin e këtyre masave.

21. Në rastin e të akuzuarit, është fakt se ai është shtetas i Kosovës dhe banon në Kosovë. Ai ka bashkëpunuar me ZPS-në, në kuptimin që i ka dhënë deklaratë ZPS-së dhe ka ardhur vullnetarisht në Holandë për t'u marrë në intervistë nga ZPS-ja.

22. Në asnjë mënyrë nuk ka qenë jobashkëpunues dhe nuk ka bërë asgjë në dëm të hetimeve të ZPS-së, siç janë kryer gjatë viteve të fundit. Në këtë kuptim asnjë incident i vetëm nuk është raportuar apo është përfshirë në materialet e tanishme të çështjes. Rrjedhimisht, nuk ka asnjë bazë që i akuzuari do të vepronte kështu nëse do të lihej në gjendje të lirë. Nëse do të bëhej një supozim i tillë, atëherë do të ishte i pabazuar në fakte.

23. Mbrojtja parashtron se nëse për të do të lëshohej një fletëthirrje për paraqitje, apo nëse do t'i kërkohej të paraqitej, atëherë i akuzuari do të paraqitet në secilën prej

seancave gjyqësore, ose me videokonferencë ose personalisht në vend. I akuzuari do ta dorëzojë vullnetarisht pasaportën, me qëllim që të garantojë mosikjen nga vendi, apo, nëse është e nevojshme, do të kërkojë leje për të udhëtuar nëse këtë ia kërkon puna. Në thelb, i akuzuari do të qëndrojë në shtëpi me familjen dhe do të vijojë punën e tij të tanishme për të siguruar të ardhura për familjen.

24. Por nëse, gjithsesi, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, në bazë të konstatimeve të veçanta, do të kërkonte zbatimin e ndonjë mase, Mbrojtja parashtron se i akuzuari do ta respektonte këtë masë.

25. Mbrojtja është e gatshme të shpjegojë secilin prej parashtrimeve të saj në një seancë gjyqësore, nëse kjo do t'i kërkohet apo nëse kjo do ta sqaronte më tej qëndrimin e Mbrojtjes dhe të të akuzuarit lidhur me këtë temë.

26. Me kaq, Mbrojtja nuk ka parashtrime të tjera për të bërë.

**Numri i fjalëve (në origjinal): 1548**

/nënshkrim/  
**Julius von Bone**

**Mbrojtës**

20 nëntor 2020

Hagë, Holandë